

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Përlësia solemne¹ / *el-Khushû'* / الخشوع

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“A nuk ka ardhur koha që atyre që besuan t’u përlulen zemrat nga kujtimi i Allahut dhe nga e vërteta që u zbriti?” (el-Hadiid, 16)

Khushû apo përlësia solemne është pasiviteti i egos (*nefsit*) dhe karakteri i shtruar² (i dëgjueshëm) para dikujt që është i lavdishëm apo frikësues.³ Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë:

- Shfaqja e përlësisë së druajtur ndaj urdhrave⁴
- Dorëzimi para caktimeve⁵
- Thyeshmëria nën vëzhgimin e të Vërtetit⁶

¹ Ky është një kombinim i gjakftohtësisë me përlësinë. Ka dhe të tjera kuptime të fjalës *khushû*, si: nënshtrim, modesti, kujdes, frikë, dhe respektim.

² Vërej sesi ai përmendi pasivitetin e egos (ngurtësinë e egos) para karakterit të dëgjueshëm. Kjo meqë përlësia e vërtetë është ajo, që ka rrënjët në zemër dhe, çfarëdo prej saj që shfaqet në karakterin e njeriut dhe në të jashtmen e tij, është diçka nga frytet e saj. Omeri ؓ pa një person kokulur dhe i tha: “Drejto qafen, se përlësia s’ka të bëjë me uljen e kokës. Ajo është në zemër.”

³ Kjo është përlësia e denjë për shpërblim. Disa njerëz janë melankolikë nga natyra; kjo s’duhet të merret gabimisht për përlësi. Ka dhe asi që shtiren si të përlulur për t’u lavdëruar nga të tjerët dhe për t’u bërë lajka të tjerëve. Sidoqoftë, përlësia (*khushû*) e vetme me të cilën do ta fitojmë shpërblimin e Allahut është ajo, që del nga të madhëruarit e Tij, nga dashuria ndaj Tij, dhe nga pranimi i gabimeve e i të metave tona që çon në përlësi, druajtje dhe thyeshmëri.

⁴ Domethënë, kërkesat dhe ndalimet e Allahut pranohen me përlësi.

⁵ Kur ti pranon me durim caktimet e Tij dhe asnjëherë nuk shfaq pakënaqësi.

Niveli i dytë:

- Të parët e gabimeve dhe të punëve të vetvetes
- Të parët e vlerës së të virtytshmëve dhe favoreve⁷ të tyre përmbi veten
- Përçafimi i puhizave të vetasgjësimit (*fanaa*)⁸

Niveli i tretë:

- Të qëndruarit respektues gjatë kohëve të zbulimit⁹
- Lirimi i kohës sate nga ndonjë pretendim¹⁰
- Të parët e mëshirës (së Zotit) pa u penguar.¹¹

⁶ Të qenët i ndrojtur dhe i thyer gjatë gjithë kohës është vetëm një rezultat i vetëdijes se vëzhgohesh nga Ai.

⁷ Të ndiesh se të gjithë njerëzit janë më të mirë se ti dhe asnjëherë të mos nënvlerësosh favorët e tyre.

⁸ Kur të jesh afër zbutjes së egos sate mburravece dhe të nisësh ta ndiesh aromën e vetasgjësimit / asgjësimit të egos (*fanaa*).

⁹ Kur të gjendesh në një bisedë të përzemërt me Allahun dhe ndien se Ai po të zbulohet, ti qëndron respektues dhe brenda kufijve të robërimit tënd.

¹⁰ Imam Ibn el-Kajim tërheq vëmendjen se në këtë nivel kjo s'do të thotë thjesht vetëm t'i shmangesh syfaqësisë (*rija*), sepse besimtarët e këtij niveli janë mbi këtë; kjo do të thotë ta fshehësh përulësinë tënde të vërtetë, nga frika se mos lajkatimi i njerëzve ndaj teje po bëhet sprovë për ty apo diçka që të shpërqendron.

¹¹ Ti sheh mëshirën e Tij ndërsa pranon se ajo është krejtësisht një favor prej Tij dhe e pamerituar nga ti. Ti nuk pranon shkak tjetër për të veç vullnetit të Tij dhe as ndikim nga tjetërkush veç Tij.